



# NJOFTIM PËR KONTRATË

## Shërbim Procedurë për kuotim çmimesh

Në përputhje me Nenin 13 të "Rregullës për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës" (Dhjetor 2024)

Data: 25.11.2025

Nr. i Prokurimit: "**BQK 25 076 234**"

### I EMRI DHE ADRESA

Emri zyrtar: Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës	
Adresa: Rr. "Garibaldi" 33, 10000 Prishtinë	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): <a href="http://www.bqk-kos.org">www.bqk-kos.org</a>	
Kontakt: Divizioni i prokurimit dhe kontraktimit	E-mail: <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a>
Telefoni: 038 222 055/452	Fax: 038 243 763

### II LËNDA E KONTRATËS

#### II.1 PËRSHKRIMI

Titulli i kontratës: " <b>Servisimi i gjeneratorit në BQK</b> "
Lloji i prokurimit: Shërbim
Vendi kryesor i realizimit: BQK
Informacione të marrëveshje afatgjatë (nëse aplikohen): N/a
Variantet pranohen: Jo
Vlera e parashikuar e kontratës: 6,800.00 euro
Ndarja në Pjesë: JO

### III INFORMACIONE PËR FURNIZIMIN

Qëllimi i kësaj kontratë është të përzgjidhet kontraktuesi i cili do të realizoj në mënyrë profesionale servisimin e gjeneratorit në BQK sipas kërkesave të BQK-së. Për më tepër informata rreth specifikimeve teknike, ofertuesit e interesuar do të njoftohen përmes Dosjes së Tenderit e cila do t'u shpërndahet në bazë kërkesave që vijnë prej tyre.

#### IV KRITERET E PËRZGJEDHJES<sup>1</sup>/KUSHTET E OBLIGUESHME PËR PJESËMARRJE

Të gjitha kompanitë (operatorët ekonomik) e interesuara janë të obliguara që t'i dorëzojnë së bashku me tenderët e tyre dokumentet për përshtatshmëri siç kërkohet këtu në vijim:

<p>Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik – <i>Kjo kategori e dokumenteve (kërkesat 1, 2 (dhe 3 në rast se aplikohet)) është e obligueshme në dorëzim me ofertë dhe se nuk mund të plotësohet dhe/ose sqarohet pas dorëzimit të ofertës!</i></p>	<p><b><u>Kërkesa 1:</u></b> Deklarata nën betim se ofertuesi përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë.</p> <p><b><u>Evidenca 1:</u></b> Deklaratë nën betim e plotësuar dhe nënshkruar duke përdorur formën në “Aneksin 3” të dosjes së tenderit.</p> <p><b><u>Kërkesa 2:</u></b> Formulari i tenderit në formën standarde siç gjendet në Dosjen e tenderit, Pjesa C, përfshirë “Deklaratën e ofertuesve”</p> <p><b><u>Evidenca 2:</u></b> Formulari i tenderit duhet të plotësohet me informatat siç kërkohen në formular (identifikimi i ofertuesit, çmimi me numra dhe fjalë, periudha e vlefshmërisë së ofertës, etj.) dhe duhet të nënshkruhet dhe vuloset.</p> <p>Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/ konzorcium, të gjithë anëtarët e grupit duhet të sigurojnë dëshmi mbi pranueshmërinë e tyre sipas kërkesave të listuara në pikat 1, 2 dhe 3.</p> <p><b><u>Kërkesa 3:</u></b> Marrëveshja mbi krijimin e grupit/konzorciumit (Kjo kërkesë aplikohet vetëm në rast se oferta dorëzohet nga një grup/konzorcium)</p> <p><b><u>Evidenca 3:</u></b>  <u>Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomikë, tenderi duhet të përmbajë një deklaratë të nënshkruar nga secili prej anëtarëve të grupit, që konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtën procedurë tenderimi. Në rast se një anëtar i një grupi tenderues merr pjesë në dy apo më tepër grupe për të njëjtin tender, secili nga grupet përkatëse ku është i përfshirë ky anëtar do të konsiderohet i papërgjegjshëm dhe përjashtohen si të tilla.</u>  Të gjithë anëtarët e grupit ose konzorciumit do të jenë së bashku dhe secili veçmas përgjegjës para Bankës Qendrore për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe nëse kontrata përkatëse i</p>
--	---

<sup>1</sup> Sipas nenit 32 të Rregullës për prokurimin në BQK “Kriteret e përzgjedhjes”

	<p>jepet grupit në fjalë, ata gjithashtu do të jenë së bashku dhe veçmas përgjegjës për ekzekutimin e kontratës në fjalë.</p> <p>Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit sipas nenit 31 të kësaj Rregulle. Kurse kërkesat për kriteret e përzgjedhjes që kanë të bëjnë me kapacitetin ekonomik, financiar, teknik e profesional, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individualë të konzorciumit.</p>
<p><i>Kërkesat mbi përshtatshmërinë profesionale – Për këtë kategori të dokumenteve (kërkesat 4, 5 dhe 6) mund të kërkojnë dokumentacion plotësues ose sqarime</i></p>	<p><b><u>Kërkesa 4:</u></b> Dëshmi nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se ofertuesi në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.</p> <p><b><u>Evidenca 4:</u></b> Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p> <p><b><u>Kërkesa 5:</u></b> Regjistrimi si ofertues në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit.</p> <p><b><u>Evidenca 5:</u></b> Kopja e certifikatës së regjistrimit me informatat mbi biznesin.</p> <p><b><u>Kërkesa 6:</u></b> Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë të lëshuar nga Gjykata.</p> <p><b><u>Evidenca 6:</u></b> Vërtetim nga Gjykata për Çështje Ekonomike i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p>
	<p>Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/ konzorcium, të gjithë anëtarët e këtij grupi duhet të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre sipas kërkesave 4, 5 dhe 6.</p>
<p>Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare</p>	<p>Nuk aplikohen</p>
<p>Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale –</p>	<p><b><u>Kërkesa 7.</u></b> Ofertuesi duhet ta plotësojë formularin standard për kontratat e ngjashme që ofrohet në Dosjen e tenderit.</p> <p><b><u>Evidenca 7.</u></b> Formulari i plotësuar dhe nënshkruar/vulosur me furnizimet e ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit (2022, 2023 dhe 2024, përfshirë edhe 2025 deri në shpalljen e këtij njoftimi për kontratë) duke saktësuar shërbimet e realizuara,</p>

<i>Për këtë kategori të dokumenteve (kërkesa 7,) mund të kërkojen dokumentacion plotësues ose sqarime</i>	shumen e kontratës, datën dhe pranuesin si dëshmi për secilën prej furnizimeve;
Inspektimi kapaciteteve teknike dhe/ose profesionale	Banka Qendrore mundet që me shpenzimet e saj të kryej ndonjë inspektim tek operatorët ekonomik tenderues për qëllime të verifikimit të kapaciteteve të kërkuara, për vërtetimin e cilësisë së furnizimeve dhe çdo informatë tjetër që është te nevojshme që mund të dëshmoj që ofertuesi mund të realizoj kontratën

## V PROCEDURA

V.1 Lloji i procedurës: “Procedure për kuotim çmimesh” (Neni 13 i Rregullës për Prokurimin në BQK)

VI. KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS: “Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët” (në përputhje me nenin 34 të Rregullës për prokurimit në BQK)

## VII. INFORMATA ADMINISTRATIVE

Kushtet për marrjen e dosjes se tenderit: Afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit, data: 02.12.2025, ora 12:00 në e-mail adresën: <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a> .
Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë, data: 02.12.2025, ora 14:00 në e-mail adresën: <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a> .
Afati i fundit i dorëzimit të ofertave, data: 04.12.2025, ora 14:00; në objektin e BQK-së, Zyra e Arkivit, rr. “Garibaldi” nr. 33, Prishtinë.
Takimi për hapjen e ofertave, data: 04.12.2025, ora 14:30, Objekti i BQK-së, rr. “Garibaldi” nr.33, Prishtinë.
Kushti i sigurimit të tenderit (ofertës): : 1,000.00 € (një mijë euro) me vlefshmëri prej 90 ditësh nga data e hapjes së ofertave
Kushti i sigurimi të kontratës: 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 30 ditëve më shumë se sa afati i kontratës.
Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 60 ditë nga data e dorëzimit respektivisht e hapjes së ofertave
Dokumentet me pagesë: Jo

## VIII. ANKESAT

Në përputhje me “Rregullën për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (dhjetor 2024)”, respektivisht sipas Neni 48 “Procedura e ankesës”, çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr Garibaldi 33, 10000 Prishtinë, [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org), brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa nga pala e interesuar duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivën e BQK-së brenda afatit për t’u konsideruar e vlefshme. Pala ankuese duhet të paguajë një tarifë për parashtrim të ankesës pranë Bankës Qendrore, vlera e së cilës do të jetë deri në 1% të vlerës së ofertës përkatëse, jo më pak se 100 euro dhe jo më shumë se 2,500 euro. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së. Ankesa e parashtruar pa dëshminë e pagesës që duhet të sigurohet nga pala ankuese do të refuzohet që në pranim të parë nga Banka Qendrore.

## IX. ADRESA

Rr. Garibaldi 33	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): <a href="http://www.bqk-kos.org">www.bqk-kos.org</a>	
Personi kontaktues: Divizioni i prokurimit dhe kontraktimit	E-maili: <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a>
Telefoni: 038 222 055/452	Fax: 038 243 763